



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:180418

Datë: 19.11.2024

Numri i dokumentit: 06474111

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.692/23

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurit B. H., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1508/23 të datës 24.08.2023 për shkak të veprës penale “Vjedhje” nga neni 313 par.1 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 15.11.2024 në prezencë të prokurores së shtetit Arlinda Nallbani Gacaferi, te pandehurit B. H. si dhe i dëmtuari J. D., me datë 15.11.2024 e shpalli, ndërsa me datë 19.11.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

B. H., i lindur me datë ..... në Pejë, ku edhe jeton Rr.”.....” nr. ..., nga i ati S. dhe e ëma Xh. e vajzërisë T., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar baba i një fëmije, me dokument identifikimi ..... i lëshuar nga MPB-Republika e Kosovës, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datën 14.07.2023 rreth orës 18:30 në Rr.”....” Pejë, në afërsi të pompës “.....”, pikërisht në restorantin “.....”, me dashje e me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete merr pasurinë e luajtshme pronë e të dëmtuarit J. D., në atë mënyrë që pasi i pandehuri shkon në vendin e lartcekur, fillimisht për një kohë qëndron afër arkës së bakshisheve, e më pas merr arkën brenda së cilës kishte të holla në vlerë prej 200 euro dhe largohet nga vendi i ngjarjes,

e që më pas policia arrin ta identifikon të pandehurin përmes video incizimeve të nxjerr nga kamerat e lokalit,

- me çka ka kryer veprën penale “Vjedhje” nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 43, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074):

#### GJYKON

Të pandehurit B. H. i shqipton:

- I. DËNIM ME BURGIM ne kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh, i cili dënim do të ekzekutohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. DENIM ME GJOBË ne lartësi prej 100 (njëqind) euro, i cili dënim KUSHTËZOHEN, nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen veprë tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- IV. I dëmtuari .... nga Peja, Rr.”....” nr. ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest juridiko civil.

#### ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 24.08.2023 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën nën shenjë PP/II.nr.1508/23, kundër të pandehurit B. H. për shkak të veprës penale “Vjedhje” nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Fillimisht prokurorja e shtetit gjatë shqyrtimit fillestar ka bërë përmisimin e aktakuzës kualifikimin juridik, ashtu që në kualifikim juridik të dispozitivit eshtë bërë një gabim teknik ku në vend të “ nenit 314 par 1 të KPRK-së ” duhet të jetë neni 313 par 1 të KPRK-së, ndërsa pjesa tjetër aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

Kjo gjykatë me datë 15.11.2024 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurorja e shtetit Arlinda Nallbani Gacaferi, dhe i pandehuri B. H. si dhe i dëmtuari J. D., në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së, gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht, po ashtu pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Kur vendosi në lidhje me dënimin kryesor gjykata u mbështet në nenin 40 par.1 pika 1.2 dhe nenin 42 par.1 si dispozita të përgjithshme, dhe dispozitën e veçantë nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074) që e përcakton veprën penale Vjedhje dhe dënimin për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim deri në tri (3) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh, i cili dënim do të ekzekutohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe dënim me gjobë në lartësi prej 100 (njëqind) euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) viteve, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke pasur parasysh se në këtë çështje penale i pandehuri e pranoi fajësinë në shqyrtim fillestar, gjykata nuk e pati mundësinë që të administroj provat e propozuara në aktakuzë, megjithatë me rastin e vlerësimit të pranimit të fajësisë dhe pas shikimit të shkresave të lëndës nga provat e

bashkëngjitura dhe deklaratimet e palëve në seancën e shqyrtimit gjyqësor gjykata arriti që të nxjerr rrethanat të cilat janë përcaktuese për llojin dhe lartësinë e dënimit.

Prokurorja e shtetit në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit deklaroi “ Meqenëse i pandehuri pranoi fajësinë, e ky pranimi fajësie gjënë mbështetjen në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës, unë mbetem në tëri pranë aktakuzës cilësimit juridik dhe i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese, ndërsa e kaluara kriminale e të pandehurit të merret si rrethanë rënduese”.

I dëmtuari J. D. deklaroi “Nuk kërkoj dëmshpërblim, unë vetëm shpresoj që ky veç është penduar për veprimet e veta”.

I pandehuri B. H. “ Më vjen keq dhe i kërkoj falje Jetmirit dhe me vjen keq që ka ndodhur ky rast ”.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin si rrethane rënduese gjeti shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të pandehurit si dhe fakti se i pandehuri edhe më parë ka qenë i dënuar dhe kjo vërtetohet me Aktgjykimet e siguruar përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve, ku i njëjti rezultoi së është dënuar me Aktgjykimet e kësaj gjykate nën shenjen P.nr. 257/21 i plotfuqishëm me dt.31.05.2023, për vepra penale të natyrës së njëjtë, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe keqardhjen e shfaqur me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dënimin më gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë shqiptimin e dënimit me gjobë dhe me burgim në mënyrë kumulative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi që të pandehurit t'i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim se bashku me dënimin me burgim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me gjobë gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej një viti do të kryej veprë tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandalojë të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata kur vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me gjobë të pandehurin pati parasysh gjendjen e tij të vështirë ekonomike pasi që i njëjti nuk punon dhe jeton në kushte të vështira, andaj dënimi me gjobë do të vështirësonte ekzistencën e të pandehurit.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua më lartë për veprën penale që është shpallur fajtor i pandehuri është parapare mundësia e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim prej një (1) deri në tri (3) vjet.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nën par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata të dëmtuarin, për realizimin e kërkesës pasurore juridike konform nenit 463 par. 1 dhe par. 2 të KPPRK-së, udhëzoi në kontest të rregullt civil.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.692/23, me datë 19.11.2024

Bashkëpunëtorja profesionale:  
Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:  
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.